



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES TË DISA QV-VE,
PËR ZGJEDHJET PËR ORGNET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR
2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 03.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Bashkia Tiranë me shkresën nr. 4936 prot., datë 28.05.2019, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjeve të:

QV-ve nr.1959, nr.1959/1, nr.1959/2, të miratuara nga KQZ në ndërtesa private, për arsye se pronarët nuk pranojnë që ambientet e tyre të shërbejnë si qendra votimi.

QV-ve nr. 2004, nr. 20041, nr. 20042, pasi ndërtesa publike ku janë të caktuara, ambientet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), ditën e zgjedhjeve do të jetë në gadishmëri të lartë, si objekt i rëndësisë së veçantë.

Kryetari i Bashkisë Lushnje me shkresën nr. 5021 prot., datë 31.05.2019, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjeve të QV nr. 2870, nr 28701, nr. 2917, të miratuara nga KQZ në ndërtesa private, për arsye të ndryshimit të aktivitetit, për të cilën bëhet e pamundur krijimi i qendrave të votimit në këto ambiente.



Nr.795 i Vendimit

Data 03.06.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes të disa QV-ve, për Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

Kryetari i Bashkisë Fier me shkresën nr. 5025 prot., datë 31.05.2019, ka kërkuar ndryshimin e vendodhjeve të QV-ve nr. nr. 3178, nr. 31781, për shkak se shkak se ndërtesat publike, shkollat janë në rikonstruksion, dhe punimet nuk përfundojnë para datës së zgjedhjeve.

Kryetari i Bashkisë Shijak me shkresën nr. 5024 prot., datë 31.05.2019, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 1386, miratuar me Vendim 126 të KQZ, datë 27.03.2019, pasi nuk ka dakortësi që ambienti të përdoret si qendër votimi.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 62, pika 4, neni 93, pika 2, gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjeve të QV-ve sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kryetari i Bashkisë të publikojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, caktuar me këtë vendim.
3. Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore të njoftojë menjëherë zgjedhësit, për vendndodhjen e qendrës së votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

